

Sigurohuni që lëndët ushqyese të ruhen në një temperaturë të barabartë ose më të madhe se 7°C.  
Përdorni solucionin ushqyes në temperaturën rreth 18°C.  
Në rast se përdoret nga ena, lutemi të vendosni një aparatnë enë për ta përzierë vazhdimisht solucionin.

Të gjitha vlerat janë për 10ltr ujë	FAZA E RRRITJES		FAZA E LULËZIMIT								
	JAVË 1	JAVË 2	JAVË 1	JAVË 2	JAVË 3	JAVË 4	JAVË 5	JAVË 6	JAVË 7	JAVË 8	JAVË 9
START	10 ml	10 ml	10 ml	10 ml							
BASIS A	10 ml	20 ml	25 ml	30 ml	30 ml	30 ml	35 ml	35 ml	30 ml	30 ml	FLUSH
BASIS B	10 ml	20 ml	25 ml	30 ml	30 ml	30 ml	35 ml	35 ml	30 ml	30 ml	
C4					5 ml	10 ml	15 ml	10 ml			
ULTIMATE PK							20 ml	20 ml	25 ml	25 ml	
EC	1.4 - 1.6	1.6 - 1.8	1.8 - 2.0	1.9 - 2.1	1.9 - 2.1	2.0 - 2.2	2.3 - 2.5	2.2 - 2.4	2.0 - 2.2	2.0 - 2.2	

Vitalize: përdorimi i rekomanduar një herë në javë

VITALIZË	FAZA E RRRITJES		FAZA E LULËZIMIT								
	JAVË 1	JAVË 2	JAVË 1	JAVË 2	JAVË 3	JAVË 4	JAVË 5	JAVË 6	JAVË 7	JAVË 8	JAVË 9
VITALIZË	2 ml	2 ml	2 ml	2 ml	2 ml	2 ml	1 ml	1 ml	1 ml	1 ml	FLUSH

UDHËZIMET E PËRZIERJES:

Ne kemi marrë një bazë EC prej 0.7

- 1) Mbushni enën me ujë.
- 2) Shtonifillimisht VITALIZË dhe përziejeni mirë.
- 3) Shtoni bazën A dhe përziejeni mirë (përdorni gjithnjë sasi të njëjtatë A + B).
- 4) Shtoni bazën B dhe përziejeni mirë (përdorni gjithnjë sasi të njëjtatë A + B).
- 5) Shtoni agjent nxitës të përshtatshëm. Përziëni mirë përpara se të shtoni agjentin nxitës të ri.
- 6) Rregulloni vlerën e pH të solucionit ushqyes (5.8 / 6.2).

**LUTEMI VINI RE:** Mos i përziëni lëndët ushqyese. Vetëm shtojini në ujë.



Faza e rritjes	faza e lulëzimit										
	Javë 1	Javë 2	Javë 1	Javë 2	Javë 3	Javë 4	Javë 5	Javë 6	Javë 7	Javë 8	Javë 9
<b>START</b>	10ml	10ml	10ml	10ml							
<b>BASIS A</b>	10ml	20ml	25ml	30ml	30ml	30ml	35ml	35ml	30ml	30ml	
<b>BASIS B</b>	10ml	20ml	25ml	30ml	30ml	30ml	35ml	35ml	30ml	30ml	Flush
<b>C4</b>				5ml	10ml	10ml	15ml	10ml	10ml	10ml	
<b>ULTIMATE PK</b>						10ml	20ml	20ml	25ml	25ml	
<b>EC (GUIDE ONLY)</b>	1.4-1.6	1.6-1.8	1.8-2.0	2.0-2.2	1.9-2.0	2.0-2.2	2.5-2.7	2.4-2.6	2.2-2.4	2.2-2.4	
	Javë 1	Javë 2	Javë 1	Javë 2	Javë 3	Javë 4	Javë 5	Javë 6	Javë 7	Javë 8	Javë 9
<b>VITALIZE</b>	2ml	2ml	2ml	2ml	2ml	2ml	1ml	1ml	1ml	1ml	Flush

1) Ushqimi i tepërt - ndryshe nga diapazonet e ushqyesve të tjerë, me linjën e ushqyesve Mills mund të jepni më shumë ushqim dhe të merrni rezultate dhe prodhime më të larta. Megjithatë, ushqejini bimët me shumë vetëm nëse jeni të bindur për njohuritë tuaja. Synoni që ushqimin ta rrisni gradualisht me kalimin e kohës - rritjet e vogla dhe të shpeshta janë më të mirat.

2) Vitalize - spërkatja e gjetheve i jep vlerë të madhe këtij produkti; përdoreni spërkatjen e gjetheve me 1 ml në 10 l ujë. MOS E QULLNI, një kalim i vetëm me spërkatës të imët mjafton. Provojeni dhe shihni vetë avantazhet e spërkatjes shtesë të gjetheve Vitalize.

3) Nivelet e PE-së - ne ju japim një nivel të përafërt PE-je që ta kenë si "objektiv". KJO ËSHTË vetëm një vlerë udhëzuese. Ne kemi përllogaritur një PE bazë prej 0,7, pra mbërrini tek ajo vlerë dhe pastaj rriteni ose uleni në varësi të PE-së fillestare. Mbani parasysh që të bazoheni gjithmonë në atë që ju tregon bima.


4) Mjedisi - ky është faktori kryesor që ju jep rezultatet më të mira - shihni udhëzuesin tonë të thjeshtë për të ngritur një miniserë për më shumë informacion rreth ngrimit të mjedisit të duhur.

5) VPD - mungesa e presionit të avullit; dëshironi rezultate tejet të mira? Mësoni më shumë rreth VPD dhe dobive që ai u sjell bimëve.

6) Përdorni gjithmonë një matës PE-je dhe pH. Nëse kultivoni pa këto pajisje bazë, do të punoni si të verbër. Blini një Komplet - është i lirë!

7) PYESNI NË NJË DYQAN KULTIVIMI nëse keni ndonjë pyetje rreth ndonjë aspekti të kultivimit dhe çfarë është më e rëndësishme, DËGJONI këshillat e tyre. Ata e njohin mirë punën e tyre.

8) Për çdo problem me ushqyesit Mills, na njoftoni në adresën [4drills@gmail.com](mailto:4drills@gmail.com)



10: Kontrolloni EC-në Rregulloni pH-në (Uji 5,8-6,2 Dheu 6,4-6,5)



LUTEMI VINI RE: Mos i përzieni lëndët ushqyese. Vetëm shtojini në ujë.

SYNONI QË USHQIMIN TA RRSINI GRADUALISHT ME KALIMIN E KOHËS - RRRITJET E VOGLA DHE TË SHPESHTA JANË MË TË MIRAT.


PE ose përçueshmëria elektrike e ujit është aftësia e tij për të përçar rrymë elektrike. Ne e matim këtë përçueshmëri me siemen ose më saktësisht me mili siemen, e cila është një e mijta e siemen. Njësoj siç janë mm për metrat në gjatësi. "Përçueshmëria elektrike" është thjesht sasia e ushqimit që qëndron pezull, të cilën mund ta përthithin e ta përpunojnë rrënjët.

Niveli shumë i ulët i PE-së do t'i bëjë bimët të uritura dhe të dobëta dhe PE-ja shumë e lartë do të "bllokojë përthithjen e mineraleve dhe do të shkaktojë djegie të gjethëve"

Uji i çezmës rrallë qëllon që është i pastër, kështu që duhet të matni ujin e burimit. Kjo kryhet më së miri me një matës PE. Për ujin e çezmës e kemi leximin PE dhe do e quajmë PE-ja bazë. Matja e PE-së bazë është e rëndësishme, sepse nga ajo do të dini me saktësi sesa ushqyes keni shtuar në ujë. Zbritni PE-në bazë nga PE-ja përfundimtare e përzierjes së ushqyesit. Pra, nëse nga çezma del një PE bazë prej 0,4 dhe leximi i PE-së përfundimtare të përzierjes së ushqyesit është 1,4 pas përzierjes së ushqyesve tanë Mills, NE E KEMI RRITUR PE-NË me 1.

Kjo PE bazë ndryshon shumë sipas zonave, në varësi të sasisë së mineraleve në ujë (pra, ujë i fortë ose ujë i butë). Si rrjedhojë, grafiku ynë i PE-së shërben vetëm si udhëzimit, por këtu do të gjeni një udhëzues referencë që do t'ju ndihmojë të përftoni nivelet e duhura të PE-së në depozitë.

Grafiku ynë i furnizimit tregon PE-në e dëshiruar për secilën javë të rritjes së bimës. Ajo mund të ndryshojë në varësi të fortësisë së ujit. Nëse jeni në një zonë me ujë të butë (0,1 - 0,4), ju këshillojmë që ta rrisni PE-në bazë deri në 0,7 dhe pastaj të shtoni ushqyesit dhe aditivët, sipas grafikut të furnizimit. Pas përzierjes, PE-ja duhet të jetë brenda diapazonit që tregohet në udhëzuesin e grafikut të PE-së.



**Për ta rritur  
PE-në shtoni  
CalMag nga  
Mills.**

MESATARJA E UJIT TË BUTË  
NË MBRETËRINË E BASHKUAR

UJË I FORTË OSE MË LART  
NË MBRETËRINË E BASHKUAR

PE-JA QË SYNOJMË PËRPARA PËRZIERJES ME USHQYESIN ËSHTË 0,7


PE-ja bazë	Ndryshoni PE-në me	CalMag shtesë për liter
0	0.7	0.77
0.1	0.6	0.66
0.2	0.5	0.55
0.3	0.4	0.44
0.4	0.3	0.33
0.5	0.2	0.22
0.6	0.1	0.11
0.7	0	0



# Mungesa e presionit të avullit (VPD) (ose lagështia optimale)

Për shëndetin e bimës, lagështia është më e rëndësishme sesa mendohet dhe është aspekt KYÇ që duhet të arrihet saktë në mjedisin e kultivimit. Kur arrini lagështinë e saktë, atëherë do të mund të kultivoni sa të mundeni. Për matjen e lagështisë ne përdorim një shkallë që quhet lagështia relative (RH). Kur RH është 50%, do të thotë që në temperaturën që matët, ajri kishte 50% të avullit të ujit që mund të mbante.

Cilat janë rezultatet që na sjell sigurimi i RH-së së duhur në rritjen më të mirë të bimëve tona? Ajo siguron që bima po merr frymë siç duhet. RH-ja shumë e ulët bën që poret e bimës të mbyllen për të parandaluar humbjen e ujit dhe përkuljen. Meqenëse bimët përrthithin CO2 nëpërmjet poreve të tyre, RH-ja optimale do të sjellë fotosintezë më të mirë, rritje më të mirë dhe bimë më të shëndetshme. Pasi ta keni rregulluar lagështinë, shtimi i CO2 në përzjerje do të shtojë prodhimin dhe do t'i japë fuqi bimës suaj.



Ky grafik është udhëzues, një rregull praktik është që për perimet të keni RH më të lartë dhe ta zbritni atë gradualisht gjatë fazës mesatare ose të vonshme të lulëzimit.